



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 60/12
Prishtinë, më 18.04.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Albana Fetoshi dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Bedri Hamza – Ministër i Financave, Ruzhdi Jashari dhe Bujar Sadiku nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 2.04.2012;**
3. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, propozoi që të bëhet një rirenditja e pikave të rendit të ditës, pika e tretë dhe e katërt të shqyrtohen si pikë e pestë dhe e gjashtë. Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 2.04.2012

Hasime Krasniqi, theksoi se diskutimi im me rastin e shqyrtimit të Raportit financiar të ZRRUM-së për vitin 2011, fare nuk është përfshirë në procesverbal dhe kërkojë që të përfshihet.

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur e komisionit më 2.04.2012, miratohet me vërejtjet e deputetes Hasime Krasniqi.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011

Ruzhdi Jashari, njoftoi për realizimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, ku janë shpenzuar 79% më pas shpenzime buxhetore në kategorinë paga dhe medijtje, mallra dhe shërbime 94%, shpenzime komunale 56% dhe pasurit kapitale kemi shpenzuar 0% për shkak të anulimit të procedurave. Kemi pas një marrëveshje bashkëpunimi më Kuvendin e Kosovës dhe të gjitha procedurat agjencisë ia ka kryer Kuvendi i Kosovës përkatësisht shërbimet e Kuvendit shërbimet mbështetëse të tij.

Kryetarja, theksoi se është një agjension që është formuar vonë, pjesa më e madhe e shpenzimeve janë të mobilet dhe pajisjet sepse ka qenë institucion i ri dhe është dashtë të furnizohen.

Xhevdet Neziraj, kërkoi sqarim për shpenzimet për qira mujore dhe shpenzimet për furnizim me mobile më pak se 1000 euro?

Salih Asllanaj, kërkoi sqarim për shpenzimet e udhëtimit?

Ruzhdi Jashari, njoftoi se kemi pas vizita detyruese në Bruksel pastaj kemi pas vizita të ndryshme me agjencitë homologe në rajon dhe kemi arritur dy marrëveshje bilaterale bashkëpunimi më Maqedoninë dhe më Shqipërinë. Në vitin vijues këto hapje të mundësive janë konkretizuar më nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale më Slloveninë dhe më Malin, marrëveshje të tilla janë obligim Nderkombtare edhe ngritje e imazhit pozitiv në sferën e mbrojtjes të të dhënave personale.

Bujar Sadiku, sqaroi e rreth mobiljeve dhe qirasë, të gjitha mobilet për agjencinë shtetërore janë blerë në kuader të kontratës të hapur të Kuvendit. Ndërsa numri i lejuar i puntorve në këtë agjenci është 20 pamvarsisht që ne ende nuk i kemi plotësuar komplet numrin e punëtorëve. Sa i përket qirasë ne në tre mujorin e fundit fillimisht edhe pse nga data 24 qershor janë krijuar obligime financiare nga pesë mbikëqyrësit kryesor shtetëror kanë qenë në një zyre të përkohshme në kuader të një institucioni tjetër, në tre mujorin e fundit kemi kalu në objekt privat bazuar dhe në atë objekt privat qiraja mujore është 3200 euro. Ne prej vitit kaluar prej datës kur kemi bërë edhe kërkesën për buxhet kemi drejtu rreth 20 kërkesa për hapësirë në drejtim të Ministrisë për Administratë Publike dhe në drejtim të Kuvendit, kemi edhe përgjigje negative.

Pas diskutimeve, Komisionit njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011

4. Projektligji për marrëdhëniet e detyrimeve, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja, njoftoi se nga analiza që iu është bërë raportit shifet se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri, nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave

Kryetarja, theksoi se kemi përpara propozim vendimin e Qeverisë, lidhur me emërimin e pesë anëtarëve në bordin për rishqyrtimin e ankesave, që propozohen dhe zgjidhen me mandat dy vjeçar sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedura. Kemi të bashkangjitur edhe CV-të e anëtarëve, shifet se kushti që së paku shtatë prej tyre të jenë nga Komiteti i Biznesit është i plotësuar. Në ligjin për Administratën Tatimore ky Bord i Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave do të pësoj ndryshime mirëpo lëndët në dispozicion duhet të shqyrtohen brenda mandatit të bordit.

Bedri Hamza, theksoi se vitin e kaluar Kuvendi ka aprovuar emërimin e anëtarëve të bordit në përbërje të plotë dhe deri më tani të gjitha ankesat e vitit 2008 janë zgjedhur dhe kanë filluar me zgjedhjen e ankesave të viti 2009. Ndërkohë 5 anëtarë të bordit kanë dhënë dorëheqje dhe duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e shqyrtimit të ankesave ne përputhje me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Qeveria e ka proceduar propozim-vendimi për zgjedhjen e tyre nga Kuvendi. Që të jetë sa më transparente Ministria e Financave ka kërkuar nga Asociacionet e Biznesit që të na dërgoj propozimet e tyre për kandidatë të propozuar për anëtarët e Bordit. Kemi vlerësuar CV-të e pranuar dhe kemi konstatuar që kandidatët e paraqitur për aprovim i plotësojnë kushtet e kërkuara ligjore. Ne në bashkëpunim me Zyrën e Komisionit Evropian jemi pajtuar se që nga muaji maj anëtarëve të bordit për ankesa t'u ofrohet asistencë teknike për ta ngritur kualitetin e punës. Ministria e Financave në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet dhe Financa në planin afatgjatë ka ndërmarrë masat për transformimin e Bordit të Pavarur për Ankesa në Divizion Fiskal.

Sali Asllanaj, kandidati Agim Thaqi nga Broja me mbiemër dhe nga fshati i Kryeministrit, mos është kjo vazhdimësi e vendosjes së njerëzve familjar në pozicionet kyçe siq ishte vëllai tash kemi këtë rast.

Latif Gashi, është e padrejtë një anëtar i komisionit sepse Broja është fshat i madhë dhe nisemi nga mbiemri, kjo do të thoshte se të gjithë njerëzve të Brojës do të duhet t'u ndalohej të jenë në institucione pa marrë parasysh qfarë përgatitje kanë dhe a i plotësojnë kushtet. Kjo do të ishte jo e drejtë.

Bedri Hamza, njoftoi se të gjitha CV-të i kemi marrur përmes institucioneve të cilat i plotësojnë interesat e komunitetit të biznesit. Konsideroj që diskutimet tona duhet të shkojnë në atë se kandidatët e propozuar a i plotësojnë kërkesat ligjore dhe nuk është korrekte dhe nuk është e drejtë prej nesh të gjykojmë që nëse dikush vjen nga një regjion, komunë, fshat apo familje dhe i plotëson kërkesat ligjore, të mos mund ta realizoj një të drejtë të vetën. Nuk ka asnjë konflikt interesash. Unë të garantoj që nuk e njoh, nuk kam pasur kërkesë që të përkrahi një kandidat të caktuar.

Muhamet Mustafa, theksoi se ne i morëm arsyetimet unë i kam lexuar CV-të, kam parë që është prej Broje, sigurisht që familja Thaqi mund të jetë e gjerë por po më pengon pse po bëhemi nervoz nëse shtrohet situata. Plotësisht është normale që në anëtarët e komisionit para se të votojmë të marrim informata. Ne kemi përgjegjësi t'i shtrojmë pyetjet të marrim përgjigje dhe të votojmë sipas koshienës. Kam shikuar CV-të dhe shihet që kanë një prapavijë profesionale secili prej tyre, personi në fjalë ka kualifikimet dhe besoj tek Ministri kur thekson që nuk ka konflikt interesash.

Bedri Hamza, për hirë të korrektësisë nga anëtarëve, propozoi që të procedohen katër anëtar për miratim në Kuvend, ndërsa kandidati i propozuar Agim Thaqi me shumë të padrejtë duke bërë një diskriminim të largohet nga propozimi, dhe ne do të zhvillojmë procedurat dhe do të propozojmë një kandidat tjetër.

Kryetarja, kërkojë që të mos personalizohen gjërat, të mos politizojmë gjëra por t'i shikojmë CV-të e kandidatëve të cilët janë propozuar sepse është e palogjikshme, e paarsyeshme, e pandërgjegjshme që për hirë të mbiemrit të largojmë dikë.

Hasime Krasniqi, theksoi se nuk kemi asnjë bazë ligjore për ta tërhequr emrin e kandidatit dhe nuk pajtohem me kërkesën e Ministrit për tërheqje, sepse me duket sikur i bëhet një e padrejtë personit në fjalë i cili i plotëson të gjitha kushtet për t'u votuat këtu.

Hykmete Bajrami, pyeti Ministrin prej cilave institucione të Komunitetit të Biznesit kanë ardhur propozimet? Unë e njoh këtë person, Agim Thaqi, por se e di se ka punuar referent në Fakultetin Ekonomik deri në zgjedhjet e dyta dhe më pas ka kaluar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik është në mesin e këshilltarëve nëse nuk gaboj, këto le të mbesin të konfirmohen Bazë ligjor nuk kemi për ta tërhequr por kur CV-të vihen në diskutim disa jem pro dhe disa kundër.

Latif Gashi, theksoi se e kuptoj modestinë e Ministrit, deputetja Hykmete na ofrojë disa informacione kush është ky person të tjerët nuk kemi informacion, së pari nuk e dijmë për përkatësinë politike të tij. Nuk jam për ta përkrahur kërkesën e Ministrit sepse CV-në e ka ndër më të mirat dhe është shumë e padrejtë në qoftë se i mohohet e drejta për shkak se është i fshatit të Kryeministrit.

Bedri Hamza, njoftoi se ne iu kemi drejtuar me kërkesë Odës Ekonomike të Kosovës, Aleancës Kosovare të Biznesit dhe Odës Ekonomike Amerikane dhe kanë propozuar kandidatët. Me qëllim që të mbrohet dhe të mos lejojmë as mundësinë më të vogël që të diskutohen tema politike që kanë të bëjnë me çështje profesionale dhe ligjore ju lutem që të procedohet me 4 anëtarët tjerë.

Kryetarja, sqaroi se ne mund të shkojmë me rekomandimin për përkrahjen e katër emrave, por Kuvendi mund të diskutojë dhe të votojë për pesë kandidatët dhe ne si komision duhet ta japim arsyeshmërin pse ne e kemi tërhequr kandidatin e pestë, dhe nëse ne bazohemi në CV e tij nuk mund të themi që shkak i CV-së e kemi hequr. Arsyetimi është që komisioni ka pasur dyshime se ka konfliktet interesi pasi ka mbiemrin dhe është nga fshati i Kryeministrit dhe kandidati përkatës ndoshta mund edhe të ankohet.

Jelena Bontic, vlerësoi se duhet të bazohemi në propozimet të cilat i kemi para nesh dhe nuk ka asnjë arsye që kandidati i pestë të tërhiqet nga lista sepse para së gjithash kandidatët e propozuar i plotësojnë të gjitha kushtet të cilat janë të përcaktuara. Mua më intereson Komuniteti i Biznesit kur ka propozuar emrat pse nuk e ka propozuar dikë nga komuniteti pakicë, konkretisht nga komuniteti serb dhe në këtë bord a është dikush anëtarë nga komuniteti pakicë.

Bedri Hamza, njoftoi se struktura e bordit është e plotësuar në përputhshmëri me kërkesat e ligjit.

Sali Asllanaj, theksoi se nuk e njeh këtë personalitet ka mundësi të jetë shumë i mirë me të gjitha kualifikimet përkatëse dhe nuk dua të bëhem një faktor që ky të tërheqet? Por kam të drejtë ta shtroj këtë çështje dhe të jam i sensibilizuar, sepse ngacmimet e vogla grumbullohen dhe japin ngacmimet e mëdha, të mos bëhemi të gjithë Thaqi. Nuk ka vetëm nga familja Thaqi eksperta të mirë ka edhe të tjerë. Studione pak rrethin dhe shiqoni njerëz që e meritojnë dhe jo pastaj bordi nuk kreu punë. Ta respektojmë ekspertizën më shumë se sa prejardhjen.

Xhevdet Neziraj, jam i mendimit që ose të kalojnë pesë kandidatët si listë ose të tërhiqen të gjithë dhe të vijë lista e re e plotësuar.

Latif Gashi: Jam dakord lidhur me propozimin e Xhevdetit dhe njëkohësisht e respektoj mendimin e te tjerëve por është shumë e padrejtë që një çështje shumë e vogël politizohet.

Bedri Hamza, kërkoi që propozim i Ministrisë së Financave për heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës tërhiqet duke i respektuar të gjitha procedurat, dhe ne si Ministri e Financave të vijmë me një propozim të ri në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Qeveria e Kosovës të procedojë katër anëtar për emërim në Bordin të Pavarur për Rishqyrtime, nga anëtarët e propozuar në propozim–vendimin e Qeverisë nr. 742/2 dt. 04.04.2012, me biografite e kompletuara në gjuhët zyrtare, që argumentojnë përgatitjet universitare, përvojën dhe trajnimet siç kërkohet me Ligjin nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, theksoi se raporti financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 përfshin të gjitha çështjet që i parasheh Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Raporti si i tillë është i detalizuar, në raport i kemi pasqyrën e të dhënave për të hyrat dhe shpenzimet qoftë në nivelin qendror apo lokal si dhe të hyrat nga donatorët. Nga tabelat vërehet se të hyrat kanë pasur rritje nga ajo që është planifikuar, që do të thotë se e dëshmon një lloj stabiliteti fiskal dhe një projeksion shumë më të mirë sa i përket të hyrave. Poashtu edhe të hyrat komunale gjatë tri viteve të fundit kanë një rritje. Ka një rritje edhe të shpenzimeve tek pozicioni i pagave dhe mëditjeve, investimet kapitale janë realizuar 87%.

Bedri Hamza, theksoi se ky raport paraqet performancën e pakontestueshëm të institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të parasë publike. Veçori kualitative të këtij raporti janë: ngritje substanciale në të hyra, tejkalim i planit të hyrave në disa kategori, ngritje kualitative në kategorinë e investimeve kapitale dhe rënie simbolike të shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve përkundër zgjerimit të dukshëm të fushëveprimit dhe institucioneve të reja. Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2011 duke mos përfshirë grantet e donatorëve dhe fondet në mirëbesim paraqesin 101% të planit të përgjithshëm vjetor, kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor dhe kemi një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2010. Të hyrat e mbledhura që administrohen nga dogana janë 64% të totalit të përgjithshëm të të hyrave apo 99.7% të planit për vitin 2011, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 18.1%. Të hyrat e brendshme që administrohen nga administrata tatimore e Kosovës arrin në 20% të totalit të përgjithshëm të të hyrave dhe janë realizuar 100.1% të planit krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat komunale marrin pjesë me 4 % në krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 6.9%. Të hyrat vetanake në nivel të përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë me 5 % dhe krahasuar me vitin paraprak kemi

një rritje prej 23.7%, ndërsa të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 3 % të të hyrave të përgjithshme. Grantet për përkrahje direkte buxhetore nga Banka Botërore janë në shumë 19 milion e 240 mijë euro. Të hyrat e arkëtuara nga dividendat janë në shumë prej 60 milion euro, nga të cilat 55 milion janë nga PTK dhe 5 milion euro nga Aeroporti. Huazimet nga institucionet ndërkombëtare kanë qenë 5 milion 76 mijë euro. Kemi pasur një kthim të të hyrat nga doganat e Kosovës 1 milion e 112 mijë euro dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës 29 milion e 774 mijë euro. Sa i përket shpenzimeve gjatë vitit 2011 duke mos përfshirë grantet e caktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim paraqesin 92% të planit të përgjithshëm vjetor, krahasuar me vitin paraprak shihet një rritje kualitative vjetore e shpenzimeve prej 9% kryesisht në kategorinë paga dhe medijtë që janë 24% dhe në kategorinë e investimeve kapitale që janë 16% më të larta se vitin 2010. Shpenzimet nga kategoria e pagave janë 28% e shpenzimeve të përgjithshme, krahasuar me planin vjetor në vitin 2011 kemi një ngjitje prej 24%. Shpenzimet nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve janë 11% e shpenzimeve të përgjithshme me realizim prej 90% të planit vjetor, krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie prej 4 %. Shpenzimet nga kategoria Shërbimet Komunale janë në shumë 1 % e shpenzimeve të përgjithshme vjetore, realizimi ndaj planit është 95%. Subvencionet dhe transferet janë 18% e shpenzimeve të përgjithshme me realizim vjetor të planit prej 96%. Shpenzimet Kapitale janë 38% e shpenzimeve të përgjithshme vjetore, realizimi vjetor është 87% dhe krahasuar me vitin 2010 kemi një ngritje prej 16%. Nga buxheti i Kosovës janë bërë edhe disa pagesa të tjera siq janë: pagesa në emër të borxhit të jashtëm të Republikës së Kosovës në shumë prej 11 milion e 491 mijë euro, është me rendësi të theksohet se në formë donacioni për këtë qëllim nga Qeveria Amerikane janë paguar 8 milion e 755 mijë euro dhe qeveria Zvicerane 527 mijë euro. Po ashtu nga buxheti i Republikës së Kosovës gjatë 2011 janë bërë pagesa në emër të kredisë së dhënë KEK-ut në shumën prej 30 milion euro. Fondet për grantet e përcaktuara të donatorëve duke përfshirë edhe bartjet nga viti 2010 kap shumën 23 milion e 350 mijë euro dhe nga ky fond gjatë vitit 2011 janë shpenzuar 16 milion e 371 mijë euro. Nga kjo shihet se gjendja e fondeve të lira për bartje dhe shpërndarje në vitin 2012 është 159 milion e 998 mijë euro.

Hykmete Bajrami, theksoi se Ajo që më brengos në tabelën numër 1 të raportit financiar të shpenzimeve të Qeverisë, i kam marrur këto shpenzime dhe i kam krahasuar me buxhetin me ligjin e buxhetit të cilin ne e kemi aprovuar dhe kemi në ligjin e buxhetit të vitit 2011 kemi pasur 383.4 milion për paga dhe janë shpenzuar diku 1 milion e 500 mijë më shumë. Për Mallra dhe Shërbime në tabelën numër 1 shihet se në buxhet janë planifikuar 161 milion gjë që nuk është e vërtetë sepse fillimisht kur e kemi aprovuar buxhetin kanë qenë 184 milion mallra dhe shërbime. Po ta merrni ligjin e buxhetit i cili është aprovuar në Kuvend Mallra dhe Shërbime janë 184 milion realizimi i tyre është 156 milion që d.m.th kemi një diferencë prej 27 milion më pakë. Subvencione dhe transfere në tabelën numër 1 janë paraqitur mirë sepse janë 271 milion. Këtu faktikisht buxheti fillestar është paraqitur buxheti pas shkurtimeve buxhetore nga ana e qeverisë apo nuk është ashtu? Do të thotë ju keni bërë shkurtimet sepse buxheti është aprovuar me 184 milion mallra dhe shërbime.

Bedri Hamza, sa i përket doganave e shohim që kemi pas një rritje të vazhdueshme njëjtë ka ndodh të administrata tatimore, sa i përket shpenzimeve të buxhetit dmth ne kemi brenda 4 viteve ne kemi një dyfishim të buxhetit derisa në 2007-ën raporti i mallrave dhe shërbimeve ka qenë 1:1 kapitali dhe mallra dhe shërbime, sot 528 milionë janë investime kapitale janë shpenzuar rreth 150 milion mallra dhe shërbime dhe kemi një rënie prej 4% në raport më periudhën e vitit paraprak. Ne i prezantojmë të dhënat ekzakte ashtu qysh është shpenzuar buxheti edhe në total edhe në strukturë. Mirëpo ju që i përmendet zonja deputete drekat, karburantet, telefonat kanë ndodhur në nivelin lokal. Nëse hymë në strukturë shohim se agjensionet e pavarura kanë ndikuar në rritjen më të madhe. Sa i përket vitit 2012 duhet ta bëjmë dallimin mes shkurtimit edhe mosalokimit, ne nuk e kemi shkurtuar buxhetin e vitit 2012, ne në qeveri kemi marr vendim sepse e kemi pjesë të marrëveshjes me FMN-në që mos të behët alokimi deri në momentin e shpalljes së fituesit për privatizimin e PTK-së të 20 milionë. Nuk ka ndodh që ndonjë organizatë buxhetore mos me i krye obligimet e veta në vitin 2011 si rezultat i mungesës së buxhetit sepse të mallrat dhe shërbimet ne kemi ekzekutuar

buxhetin në masë 90%. Kur i referohemi obligimeve të pakryera shumica janë obligimet dhe fakturat të muajit dhjetor dhe ato janë fakturuar dmth realisht edhe janë ardhur për pagesë në muajin janar sepse nuk kanë mujt në muajin dhjetor me u pague.

Latif Gashi, theksoi se raporti është gjithëpërfshirës, i detajuar dhe i strukturuar mirë, dhe përmban të gjitha të dhënat që kërkohen me ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, shifet se kemi progres në realizimin e të hyrave dhe në përgjithësi në menaxhimin e financave publike dhe si tillë raporti është për tu vlerësuar

Muhamet Mustafa, theksoi se që ky raport është i një kualiteti më të mirë se sa raporti i vitit të kaluar, i kemi strukturat, i kemi përqindjet, i kemi krahasimet më vitin e kaluar. Diqka që mungon është që të kemi një pasqyrë të ardhmen të pjesëmarrjes në buxhet sipas veprimtarive prej vitit në vit sepse aty shohim qëndrueshmërinë e politikave si dhe të shohim shpenzimet e shpenzuesve më të mëdhenj. Sa i përket pozitives mendoj që janë rrit kapacitetet e mbledhjes të ardhurave. Ajo që unë jam i brengosura është se ne duhet të bëjmë një kontinuitet më investimin në fushën e arsimit edhe shëndetësisë.

Xhevdet Neziraj, theksoi e për mua është shqetësuese se po kemi agjensione që në qira po kanë shpenzime shumë të mëdha. Ndërsa sa i përket përgatitjes së raportit nga Ministria e Financave, shifet se janë përmbledhur të gjitha të hyrat dhe dalurat ashtu siq kërkohet.

Kryetarja, mendojë që raporti i plotëson kushtet për tu proceduar në seancë plenare për miratim dhe të gjitha kërkesat ligjore për raportim që i parasheh ligj, raporti i përmban.

Pas diskutimeve, Komisioni me gjashtë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Muhamet Mustafa dhe Xhevdet Neziraj), asnjë Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj